VENDIM
Nr. 808, datë 12.12.2022

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, TË PRONËS ME EMËRTIM "AGJENCIA LUNDËR", ME VENDNDODHJE NË LUNDËR, TIRANË, ZONA KADASTRALE 2529, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 413, DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronës me emërtim "Agjencia Lundër", me vendndodhje në Lundër, Tiranë, zona kadastrale 2529, sipas plan-rilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ngritjen e një kompleksi argëtimi dhe sportiv.
2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 413, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit)", të ndryshuar, hiqet prona me emërtim "Agjencia Lundër", me vendndodhje në Lundër, Tiranë, zona kadastrale 2529, sipas plan-rilevimit që i bashkëlidhet vendimit.
3. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, si dhe tjetërsimi i pronës.
4. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, përpara marrjes në dorëzim të pronës, të lidhë aktmarrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Ministrinë e Drejtësisë (Arkivin Shtetëror të Ministrisë së Drejtësisë), për plotësimin e nevojave të tyre, sipas projektit të paraqitur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe dakordësuar midis palëve respektive, për të garantuar vazhdueshmërinë e funksionalitetit të këtyre institucioneve.
5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku


PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE
Prona "Rezervat Matriale të Shtetit Agjencia Lundër", Farkë
PRONARI SHTET, MM, (Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Matriale të Shtetit) DATË 04/11/2022 QËLLIM DPRMSH
VENDNDODHJA
Bashkia Tiranë ZVASHK Tiranë Nr.Pasurisë 867 Z.K 2529
TE DHËNAT E PASURISË
Lloi i pasurisë Sip e pasurisë 95 320 m² Sip. e gjurmës së ndërtimit 10 884m²
Nord =4571974.77
East = 488468.83
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH
857/1/28
857/1/29
857/1/27